



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja c, nenit 17, shkronja f, dhe të nenit 40, paragrafi 2, shkronja a të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 qershor 2008), të nenit 15, shkronja a dhe f të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/03 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.338/shtator 2016, Prishtinë) të nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, si dhe nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja f, nenit 33, paragrafi 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391 e dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më dt. 21.12.2023, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

### **Neni 1** **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe kritereve të vendparkimeve publike dhe private, për caktimin e zonave, mënyrën e pagesës, çmimet dhe llojet e biletave për vendparkim, procedurën e paraparë për krijimin dhe operimin e parkingjeve private, mënyrën e shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjen për parkimin e automjeteve në gjithë territorin e Prishtinës (më tutje kryeqyteti).

### **Neni 2**

Hapësira publike e parkimit është hapësirë e dedikuar për parkimin e automjeteve, e cila është e rregulluar si vendparkim, e shenjuar me shenja të komunikacionit dhe me informata rreth zonës së parkimit, çmimeve, varësisht nga koha e parkimit dhe mënyra e pagesës së parkimit. Kjo hapësirë përfshin edhe segmentet të cilat janë pjesë e hapësirës publike të parkingut. Segmenti i menaxhuar nga NPL "Prishtina Parking" përfshin vendparkime publike, hapësirën e mesme për qarkullim të

automjeteve në parking, ishujt dhe oazat gjelbëruese, si dhe trotuaret përreth parkingut. Segmentet duhet të jenë të sinjalizuara.

### **Neni 3** **LLOJET E PARKINGJEVE**

1. Llojet e parkingjeve në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohen:

1.1. Vendparkimet publike me kohë të caktuar, të cilat përfshijnë:

1.1.1. Vendparkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vendparkime publike, në të cilat përfshihen edhe vendparkimet me laura të mbyllura;

1.1.2. Vendparkimet “Parko & Udhëto” (Park & Ride);

1.1.3. Vendparkimet me PPP – garazhet;

2. Parkingjet private.

2.1. Lejet për operimin e parkingjeve private i lëshon Drejtoria e Shërbimeve Publike (më tutje DSHP), duke u bazuar në Planin e mobilitetit, strategjinë dhe vizionin e kryeqytetit.

2.2. Kriteret për operimin e parkingjeve private caktohen nga DSHP duke u bazuar dhe përshtatur në Planin e mobilitetit.

2.3. Revokimi i lejes së operimit apo çdo ndërhyrjeje tjetër mund të bëhet nga DSHP duke u thirrur në nevojat e implementimit të Planit të mobilitetit apo projekteve me interes të kryeqytetit.

3. Zonimi i parkingjeve përgatitet nga DSHP duke u përshtatur me Planin e mobilitetit.

4. Çmimoret përcaktohen nga organi kompetent i Kryeqytetit, duke u ndërlidhur me zonimin.

5. Për të gjitha vendparkimet si në paragrafin 1 të këtij neni, vlen çmimorja e miratuar nga Kuvendi Komunal i Kryeqytetit, shtojcë e kësaj rregulloreje.

### **Neni 4**

1. Vendparkime publike janë të gjitha vendparkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vendparkime publike, që menaxhohen nga Ndërmarrja publike lokale “Prishtina Parking”, SHA.

2. Hapësirat e vendparkimeve publike me vendim të veçantë nga Drejtoria për Shërbime Publike mund t'ju jepen në shfrytëzim institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe diplomatike.
3. Vendparkimet si në pikën 1.1 paguhen në Ndërmarrjen publike lokale "Prishtina Parking" SH.A., sipas çmimoreve të përcaktuara nga Kuvendi i Kryeqytetit.
4. Vendparkimet me PPP – garazhet menaxhohen nga operatori privat, i përzgjedhur përmes procedurave të prokurimit.
5. Vendparkimet private janë të gjitha ato vendparkime, të cilat i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga kjo rregullore, si në vijim:
  - 5.1. Certifikatën e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;
  - 5.2. Marrëveshje apo kontratë e noterizuar me pronarin-ët e ligjshëm për shfrytëzimin e hapësirës së caktuar si vendparkim;
  - 5.3. Projektin për kyçje dhe funksionet e hapësirës së vendparkimit, i hartuar nga inxhinieri i komunikacionit rrugor;
  - 5.4. Hapësira për vendparkim të ketë së paku 10 vendparkime;
  - 5.5. Kyçja të mos lejohet në rrugën e cila ka më tepër se dy shirita për kahje të njëjtë të lëvizjes;
  - 5.6. Parkingu duhet të ketë qasje direkte në rrugë, jo të kalojë përmes trotuarit;
  - 5.7. Të ketë shenjëzim horizontal dhe vertikal;
  - 5.8. Shtrimin me kubze betoni, asfalt;
  - 5.9. Të ketë sistemin e kamerave.
6. Lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste të parkingjeve e lëshon Drejtoria e Shërbimeve Publike, pas rekomandimit mbi plotësimin e kriterëve sipas nenit 4, paragrafit 3 të kësaj rregulloreje, nga ana e një komisioni të themeluar nga kryetari dhe i përbërë nga përfaqësuesit e DSHP, DI dhe DU.
7. Afati i vlefshmërisë i Lejes së operimit i lëshuar sipas nenit 4, është gjashtë (6)vjet nga momenti i pajisjes me Leje të operimit.
8. Revokimi (heqja e së drejtës) i Lejes së operimit, mund të bëhet në çdo kohë kur konstatohet nga ana e Drejtorisë së Inspektionit se subjekti përkatës nuk i është përmbajtur kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.

9. Në momentin e pajisjes me leje si në nenin 4, paragrafi 5, operatori obligohet të pajiset me arkë fiskale.
10. Kuponi fiskal duhet të lëshohet për secilin shfrytëzues në momentin e fillimit të kohës së parkimit.
11. Taksa për dhënien e lejes si në nenin 4 do të jetë:
- 11.1. Për marrjen e Lejes së përgjithshme të operimit, secili aplikues duhet të paguajë taksën e përgjithshme në vlerë prej 1000.00 euro, dhe
- 11.2. Taksën vjetore për secilin vendparkim sipas ndarjes së mëposhtme:
- 11.2.1. ZONA I (qendra e qytetit) – 100.00 euro për një vendparkim;
- 11.2.2. ZONA II - 50.00 euro për një vendparkim;
- 11.2.3. ZONA III për një periudhë prej dy (2) vitesh prej hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të lirohet nga kjo taksë.
12. Përcaktimi i zonave është i përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

## Neni 5

1. Vendparkimet publike që menaxhohen nga N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A., janë:
- 1.1. Vendparkimet publike për banorë rezidentë.
- 1.2. Vendparkimet publike të përhershme apo të përkohshme, rrugore dhe jashtërrugore, si dhe çdo hapësirë tjetër publike e cila mund të shfrytëzohet si parking publik.
- 1.3. Vendparkimet e përkohshme publike në të cilat parkimi paguhet gjatë organizimit të përkohshëm të komunikacionit, gjatë organizimit të manifestimeve të ndryshme, ngjarjeve dhe të ngjashme.
- 1.4. Vendparkimet rrugore publike të cilat gjenden në rrugë dhe trotuare, të shenjuara në mënyrë të veçantë me shenja horizontale dhe vertikale, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me dokumentacion teknik.
- 1.5. Vendparkimet jashtërrugore publike të cilat gjenden jashtë rrugës dhe të shenjuara me shenjat vertikale dhe horizontale, e të cilat përcaktohen me projekt të veçantë.
2. Vendparkingjet të cilat menaxhohen nga "Prishtina Parking" definoohen përmes segmenteve të kodifikuara që duhet të jenë të ndërlidhura me adresën përkatëse.

**Neni 6**  
**VENDPARKIMET “PARKO DHE UDHËTO” (Park & Ride)**

1. Vendparkimet “Parko dhe Udhëto” (Park & Ride) janë parkingjet e lokalizuara sipas Planit të mobilitetit në distanca më të mëdha larg qendrës së kryeqytetit dhe të lidhura me një shërbim të transportit publik që bën ndërlidhjen me zonën urbane të kryeqytetit, të cilat organizohen nga N.P.L “Prishtina Parking” SH.A.
2. Lokacioni i vendparkimeve “Parko dhe Udhëto” duhet të jetë i pozicionuar mirë, të arrihet lehtësisht dhe të jetë i dukshëm ose i shenjzuar mirë nga anët e rrugëve kryesore për qasje.
3. Kostoja e shërbimit të vendparkimit “Parko dhe Udhëto” në periferi duhet të jetë e arsyeshme dhe më e ulët në krahasim me zonat tjera.
4. Lokacioni duhet të ofrojë elemente tjera përcjellëse si: strehim, siguri, ndriçim dhe dukshmëri të mirë.
5. Lokacionet e vendparkimeve “Parko dhe Udhëto” mund të rishikohen dhe të përcaktohen duke marrë për bazë, por duke mos u kufizuar në specifikat si në vijim:
  - 5.1. Mundësinë e përcaktimit të lokacioneve të ndryshme në pajtim me politikat e kryeqytetit;
  - 5.2. Vendndodhjen dhe projektimin e hapësirave të vendparkimit;
  - 5.3. Klientelën, ofrimin e mënyrave tjera të lëvizjes dhe kapacitetin për biznes;
  - 5.4. Lidhshmërinë me vendparkimet në dispozicion në zonën qendrore të qytetit, kostos së parkimit në zonën qendrore, dhe
  - 5.5. Lidhshmërinë me propozimet tjera brenda Prishtinës duke përfshirë zhvillimin e itinerareve të linjave kryesore dhe dytësore të trafikut publik.

**Neni 7**  
**MËNYRA E PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË PARKIMIT**

1. Përcaktimi i saktë i zonave, si dhe i hapësirave të cilat mund të shfrytëzohen si hapësira të parkingut brenda këtyre zonave bëhet me aprovimin paraprak dhe në përputhje me Planin e mobilitetit nga ana e një komisioni të themeluar nga kryetari dhe i përbërë nga përfaqësues të: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Urbanizmit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtorisë së Inspeksionit dhe Drejtorisë së Planifikimit.

2. Për shtim të njësive të reja të vendparkimeve, për pronat komunale që kanë mundësi të shndërrohen në parkingje publike, N.P.L., “Prishtina Parking” SH.A., duhet të parashtrijë propozimin e saj te Drejtoria e Pronës.

### Neni 8

#### MENAXHIMI DHE KLASIFIKIMI I HAPËSIRAVE TË VENDPARKIMEVE PUBLIKE

**1. Hapësira rezidenciale**, - është hapësirë e parkimit e përcaktuar për banorët rezidentë të adresës specifike. Vetëm banorët e adresës përkatëse, të regjistruar pranë ndërmarrjes “Prishtina Parking” mund të parkohen në këto hapësira. Personat tjerë mund të përdorin këto vendparkime vetëm deri orën e përcaktuar nga N.P.L “Prishtina Parking”. Njoftimi i orëve të kufizuara për vizitorë vendoset në tabelën vertikale në hyrje të parkimit rezidencial. N.P.L “Prishtina Parking” përmes analizave numerike e përcakton orarin e ndalimit të parkimit për vizitorë. Ky kufizim i parkimit për vizitorë nuk mund të jetë më herët se ora 16:00 dhe më vonë se ora 18:00. “Prishtina Parking” nëpërmjet rregulloreve të brendshme, të cilat duhet të jenë publike, e përcakton metodën dhe kushtet e shfrytëzimit të parkimit për vizitat familjare të banorëve rezidentë.

**2. Hapësirë komerciale**, - e shënuar me sinjalizim vertikal është e përcaktuar për vizitorët dhe paguhet për çdo orë qëndrimi.

**3. Hapësirë e kombinuar**, - është hapësirë e parkimit rrugor e cila mund të përdoret nga banorët rezidentë dhe vizitorët në oraret e përcaktuara nga “Prishtina Parking” me sinjalistikë vertikale.

### Neni 9

#### ZONAT E PARKINGJEVE

1. Vendparkingjet publike klasifikohen në zona:

**1.1. ZONA I** (qendra e qytetit) përfshin hapësirën brenda dhe përgjatë perimetrit të unazës qendrore të kryeqytetit.

**1.2. ZONA II** - hapësira që përfshihet nga përfundimi i zonës së parë (ZONA I), përgjatë dhe brenda unazës së brendshme të kryeqytetit.

**1.3. ZONA III** – hapësira që përfshihet nga përfundimi i unazës së brendshme (ZONA II) deri në kufijtë e zonës urbane.

2. Unaza qendrore dhe unaza e brendshme përcaktohen me dokumente të planifikimit hapësinor.

3. Zonimi/ndarja dhe përcaktimi i hapësirave publike të destinuara si vendparkingje publike, duhet të bëhet nga një komision i themeluar nga ana e kryetarit dhe i përbërë nga përfaqësuesit e DP, DSHP, DU, DI dhe DP.

### **Neni 10**

#### **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL**

1. Parkingjet janë sipërfaqe për parkimin e automjeteve, të cilat përbëhen nga një apo më shumë vende të parkimit. Vendparkimet duhet të jenë të sinjalizuara (vertikalisht dhe horizontalisht) me qëllim që automjetet të mund të parkohen në hapësira parkimi sipas dimensioneve si në vijim: (të barten nga UA për normat teknike të planifikimit hapësinor MMPH-08/2017).

1.1. Vendparkimi në 90° - 250 cm X 455 cm, gjerësia e kalimit 550 cm për lëvizje një ose dykahore;

1.2. Vendparkimi në 60° - 250 cm X 485 cm, gjerësia e kalimit 470 cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.3. Vendparkimi në 45° - 250 cm X 485 cm, gjerësia e kalimit 350 cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.4. Vendparkimi në 30° - 250 cm X 425 cm, gjerësia e kalimit 350 cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.5. Vendparkimi në 0° - 215 cm X 640 cm, gjerësia e kalimit 350 cm për lëvizje njëkahore dhe 550 cm për lëvizje dykahore;

1.6. Vendparkimi i rrethuar – 270 cm X 550 cm;

2. Vendet për parkim shënohen me vija në gjerësi prej 12 cm. Vendet e veçanta të parkimit (për invalidë, vende të rezervuara) shënohen me ngjyrë të kaltër.

3. Vendosja e shenjave horizontale/vertikale të trafikut në vendparkingjet publike që gjenden nën menaxhimin e N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A., bëhet nga ndërmarrja.

### **Neni 11**

#### **OFRIMI I SHËRBIMEVE PËR PARKIM**

1. Ndërmarrja Publike lokale "Prishtina Parking" SH.A., ofron shërbime publike për qytetarët e Komunës së Prishtinës, si në vijim:

1.1. Parkimin në parkingjet me laura;

Faqe 7 nga 21

- 1.2. Parkimin në parkingjet komerciale;
- 1.3. Parkimin në parkingjet për banorë rezidentë.

2. N.P.L “Prishtina Parking” SH.A., mund të asistohet në mbarëvajtjen e punëve operative në terren nga Policia e Kosovës (policia sekondare), në bazë të marrëveshjes së dyanshme mes tyre.

## **Neni 12**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PARKIMIT**

1. N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., nuk mban përgjegjësi për dëmet që shkaktohen si pasojë nga vjedhja, shkatërrimi apo dëmtimi i automjetit të shfrytëzuesit në vendparking dhe nuk ka për obligim ruajtjen e automjeteve të parkuara në vendparkingjet që gjenden nën menaxhimin e ndërmarrjes, e as kompensimin e dëmeve eventuale.
2. Personat e regjistruar për shfrytëzimin e vendparkingjeve të ndërmarrjes pajisen me kartë ose regjistrim dixhital të parkimit të caktuar për automjet, e cila duhet të përmbajë afatin e vlefshmërisë dhe e cila vlen vetëm për adresën në të cilën është regjistruar.
3. Regjistrimi dixhital nuk është i transferueshëm tek palët tjera.
4. Klientët obligohen që të paguajnë shfrytëzimin e parkimit sipas sinjalistikës, si dhe sipas çmimore, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
5. Të gjitha automjetet që shfrytëzojnë parkingjet e menaxhuara duhet të jenë me regjistrim valid, me policë sigurimi, si dhe të kenë të kryera kontrollet teknike. Automjetet që nuk plotësojnë kushtet e qarkullimit rrugor nuk mund të parkohen në vendparkingjet e menaxhuara nga N.P.L “Prishtina Parking”.
6. Në rast të mosvazhdimin të pagesës për vendparkim, karta do të konsiderohet e pavlefshme nga N.P.L. “Prishtina Parking” SH. A.
7. N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., ofron mundësi të parkimit në lokacionin e destinuar për hapësirë parkimi për banorët rezidentë të adresës përkatëse, por nuk paracakton vendparkim të individualizur për secilin parapagues.
8. N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., mban përgjegjësinë dhe do të rimbursojë konsumatorët sipas procedurave të brendshme të ndërmarrjes, në rast se konstatohen probleme teknike në sistemin e pagesave të ndërmarrjes.
9. N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., nuk mban përgjegjësi të rimbursimit klientëve për gabimet teknike të kryera nga ana e tyre në rastin e kryerjes së pagesës.
10. “Prishtina Parking” themelon një komision të përhershëm për trajtimin e gabimeve teknike nga ana e klientëve për të vlerësuar nëse ka kushte të rimbursimit. Ky komision, ka të drejtë



të anulohet biletat 24-orëshe të parkimit në raste të arsyeshmërisë së plotë. Për çdo përgjigje që ky komision kthen ndaj ankesave të klientëve, "Prishtina Parking" duhet të vë në dispozicion platformë online lidhur me publikimin e vendimit nëse kërkohet nga klienti.

11. Për shkak të nevojës për të ofruar siguri të shtuar për parkingjet, të vendosen kamerat e sigurisë.

### **Neni 13**

## **REGJISTRIMI PËR SHFRYTËZIMIN E VENDPARKIMIT**

1. Qytetarët kanë të drejtë të regjistrojnë vetëm një (1) veturë për shfrytëzimin e vendparkingut në zonën ku jetojnë, punojnë apo ushtrojnë veprimtarinë e tyre, pavarësisht nëse janë banorë rezidentë, punëtorë apo persona juridikë. N.P.L "Prishtina Parking" do të mbajë prioritet alokimit të regjistrimit për banorët e lagjes kundrejt punonjësve apo personave juridikë.

2. Për shkak të mungesës së hapësirave për parkim, vetëm pas përfundimit të regjistrimit të një (1) veture për të gjithë personat sipas paragrafit 1 të këtij neni, qytetarët e interesuar mund të aplikojnë për regjistrimin e veturës së dytë. Regjistrimi i veturës së dytë nuk mund të bëhet pa përfunduar procedura e regjistrimit të automjetit të parë për secilën shtëpi/njësi banesore apo person juridik të zonës së caktuar.

3. Me përfundimin e regjistrimit të veturës së dytë, sipas procedurës së regjistrimit të veturës së parë dhe sipas paragrafit 2 të këtij neni, qytetarët e interesuar mund të aplikojnë për regjistrimin e veturës së tretë.

4. Banorët rezidentë dhe pronarët e lokaleve afariste kanë prioritet ndaj kategorive tjera në regjistrimin e veturave, sipas mënyrës së përcaktuar me këtë rregullore.

5. Bizneset e fushëveprimit të hotelerisë mund të nënshkruajnë kontratë me N.P.L "Prishtina Parking", për të siguruar lejet e parkimit afatshkurta për vizitorët e tyre me qëndrim/fjetje. Kjo leje afatshkurtër duhet të përmbajë detajet e rrugës/segmentit të përcaktuara nga N.P.L "Prishtina Parking" se ku do të ketë vlefshmëri parkimi. Kjo leje nuk mund të jetë më e gjatë se pesë (5) ditë.

6. Në rast të ndërrimit të targave/automjetit, personat e regjistruar për shfrytëzimin e parkingjeve duhet të regjistrohen përsëri në N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A.

### **Neni 14**

## **MËNYRA E PAGESËS**

Mënyra e pagesës së parkimit të menaxhuar nga N.P.L. "Prishtina Parking" SHA, do të përcaktohet nga ana e kësaj ndërmarrjeje përmes një akti të saj të brendshëm.

**Neni 15**  
**BILETAT E RREGULLTA TË PARKIMIT – ORËSHE DHE DITORE**

Propozimin e çmimit për shfrytëzim të vendparkimit, si dhe kohëzgjatjen e atij shfrytëzimi, duhet ta përmbledhim për periudhën kohore gjatë ditës. Për këtë arsye, propozohet periudha kohore në të cilën është vendosur regjimi i propozuar i shfrytëzimit gjatë ditës. Prandaj, për 3 orët e para do të paguhet çmimi i biletës orëshe, ndërsa vazhdimi i parkimit do të ishte karakterizuar si parkim gjatë gjithë ditës dhe në këtë rast do të shitet bileta ditore e parkimit.

**Neni 16**  
**BILETAT MUJORE DHE VJETORE TË PARKIMIT**

1. Banorëve rezidentë do t'ju ofrohet mundësia e parkimit të privilegjuar në kapacitetet publike të parkimit në adresën e tyre.
2. Për këtë qëllim duhet të kryhet procedura e nevojshme administrative, të paguhen tarifat administrative të regjistrimit dhe shpenzimet materiale të lëshimit të biletës së parkimit të privilegjuar.
3. Për t'u pajisur me biletë të privilegjuar, aplikuesi duhet të sjellë dokumentacionet të cilat konfirmojnë rezidencën dhe pronësinë e automjetit. Dokumentet e kërkuara janë:
  - 3.1. Certifikata e tatimit në pronë;
  - 3.2. Leja e vlefshme e qarkullimit dhe pronësia e automjetit si person fizik.
  - 3.3. Në raste kur certifikata e tatimit në pronë nuk është e njëjtë me pronarin e automjetit, duhet të bashkëngjitet në aplikacion certifikata e bashkësisë familjare.
  - 3.4. Në raste kur banori rezident shfrytëzon pronën nëpërmjet kontratës së qiramarrjes, aplikacionit i bashkëngjitet kontrata e noterizuar dhe dëshmia e pagesës së tatimit në qira.
  - 3.5. Nëse për ndonjë arsye nuk është e mundur të silllet dokumentacioni si në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni, aplikuesi duhet të sjellë faturën e energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe ujësjellësit për të konfirmuar rezidencën.
  - 3.6. Në rast se automjeti nuk është në emër të pronarit të njësisë rezidenciale, duhet të silllet autorizimi i noterizuar për vozitje, si dhe kontrata e shitblerjes së automjetit e noterizuar. Në këtë rast pajisja me biletë të privilegjuar nga N.P.L "Prishtina Parking" nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e regjistrimit të automjetit në Qendrën e Regjistrimit Civil.

4. Automjetet e personave juridikë, të cilët kanë autorizim të shfrytëzimit të automjetit nga personi fizik nuk mund të regjistrohen si automjet i parë.
5. Automjetet të cilat janë në pronësi të personit juridik, por që janë subjekt i blerjes përmes kontratës lizing, duhet të sjellin autorizimin e noterizuar për vozitje, si dhe një kopje të kontratës së lizingut.
6. Shfrytëzimi i privilegjuar i vendparkimeve u referohet tri kategorive të shfrytëzuesve dhe me prioritet, sipas renditjes në vijim:
  - 6.1. Banorët të cilët jetojnë në rrugën përkatëse (rezidentë);
  - 6.2. Personat juridikë të cilët e kanë selinë e vet në rrugën ku parkimi paguhet, vetëm për veturat e tyre zyrtare;
  - 6.3. Të punësuarit të cilët punojnë në zonën ku parkimi paguhet, varësisht nga gjendja ekzistuese në vendparking.
7. Për kategorinë e përmendur në paragrafin 6.1 deri 6.3 të këtij neni do të lëshohet "BILETA ELEKTRONIKE E PARKIMIT TË PRIVILEGJUAR, (e BPP) me të cilën pronari (shfrytëzuesi) i veturës do të identifikohet dhe në bazë të së cilës do të mund ta shfrytëzonte cilindo vendparkim në adresën e caktuar, pa kufizim kohor.
8. "e-BPP" lëshohet në arkë në version elektronik dhe nuk ka nevojë që e njëjta të shtypet, që do të thotë se i zvogëlon shpenzimet dhe e largon mundësinë e falsifikimit të së njëjtës.
9. Bileta e privilegjuar për këto tri kategori të shfrytëzuesve, nuk nënkupton rezervimin e ndonjë vendi të caktuar të parkimit, pra vetëm mundësinë e shfrytëzimit të vendparkimit në kushtet e privileguara.
10. Në rastin e pagesës mujore apo vjetore për shfrytëzim të parkingjeve, personat juridikë obligohen të paguajnë vlerën për pagesë sipas çmimores së miratuar nga Kuvendi Komunal i Kryeqytetit dhe vlerën prej 9 % të tatimit mbi qiranë sipas Ligjit nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

## **Neni 17 PARKINGJET E REZERVUARA**

Personat fizikë dhe personat juridikë kanë të drejtë të rezervojnë hapësirat për parkim në vendparkingjet publike, të cilat gjenden nën menaxhim të N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A., me pagesë të çmimit të përcaktuar sipas çmimores së miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.

**Neni 18**  
**MËNYRA E PAGESËS SË ÇMIMIT PËR PARKIM**

1. Për shfrytëzimin e parkingut, shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë çmimin e parkimit, varësisht nga koha e shfrytëzimit të vendparkimit dhe zonës në të cilën gjendet vendparkimi.
2. Çmimi propozohet nga një komision i themeluar nga ana e kryetarit dhe i përbërë nga përfaqësuesit e DP, DSHP, DU, DI, DP dhe i miratuar nga Kuvendi Komunal i Kryeqytetit.
3. Shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë çmimin e parkimit për çdo orë të filluar të shfrytëzimit.
4. Shfrytëzuesi është i obliguar të respektojë kohën e lejuar për parkim.

**Neni 19**  
**SHFRYTËZIMI I PARKINGJEVE**

1. Përdoruesi i parkimit brenda kuptimit të dispozitave të kësaj rregulloreje konsiderohet vozitësi ose pronari i një automjeti nëse vozitësi nuk identifikohet, i cili ka parkuar automjetin në parking.
2. Pagesa e parkimit në Zonën I bëhet çdo ditë të javës, duke filluar nga ora 07:00 deri në ora 23:00. Pagesa nuk kryhet të shtunave, të dielave dhe ditëve të festave zyrtare.
3. Pagesa e parkimit në Zonën II bëhet çdo ditë, në intervalin kohor prej orës 07:00 deri në ora 23:00. Pagesa nuk kryhet të shtunave, të dielave dhe ditëve të festave zyrtare.
4. Pagesa e parkimit në parkingjet me laura në Zonën I dhe II bëhet çdo ditë dhe sipas orareve të përcaktuara, me Rregullore të brendshme të NP "Prishtina Parking".
5. Përdoruesi i parkingut është i obliguar që:
  - 5.1. të përdorë vendin e parkimit në përputhje me sinjalizimin e trafikut, vertikal dhe horizontal, me të cilin është shënuar vendi i parkimit;
  - 5.2. të veprojë në përputhje me kufizimin e kohës së shfrytëzimit të hapësirave të parkimit të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje;
  - 5.3. të paguajë përdorimin e hapësirave të parkimit sipas kohës së mbajtjes, në mënyrën e përcaktuar dhe sipas listës së çmimeve të vlefshme pas kohës së fillimit;
  - 5.4. deri në skadimin e kohës së parkimit të paguar dhe në përputhje me këtë rregullore ta largojë automjetin nga parkingu.

6. Për vendparkingjet e destinuar për banorët rezidentë, N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A., obligohet të njoftojë së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara banorët rezidentë mbi vendparkimin e ri në mënyrë të detajuar, përfshirë informatat mbi periudhën kohore brenda së cilës duhet të regjistrohen, mënyrën e kryerjes së pagesës, mënyrën e shfrytëzimit të parkingut dhe informata të tjera.

#### **Neni 20**

### **KATEGORITË E LIRUARA NGA OBLIGIMI I PAGESËS PËR PARKIM**

1. Nga obligimi për pagesën e shfrytëzimit të vendparkingjeve, lirohen kategoritë si në vijim:

1.1. Veturat zyrtare të Komunës së Prishtinës;

1.2. Veturat diplomatike;

1.3. Personat me aftësi të kufizuara ose personi shoqëruar i tij;

1.4. Automjetet zyrtare të shërbimeve emergjente (automjetet me targa të policisë, zjarrfikësit dhe shërbimet shëndetësore).

1.5. Invalidët e luftës së Republikës së Kosovës, në hapësirat e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

2. Për inkuadrim në sistem të veturave të liruara, obligohen aplikuesit që të paraqesin në N.P.L "Prishtina Parking" dokumentacionet si në vijim:

2.1. Kopje të Lejes së vlefshme të qarkullimit të automjetit, për të gjithë paragrafët nga 1.1 deri në 1.4 të këtij neni;

2.2. Dokumentet mjekësore sipas një procedure të brendshme të N.P.L "Prishtina Parking" për aplikimet sipas paragrafit 1.3 të këtij neni.

#### **Neni 21**

### **NDALESAT E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE**

1. Parkimi dhe ndalimi i automjetit në kundërshtim me shenjat e trafikut, sinjalizimi horizontal dhe vertikal.

2. Parkimi i automjetit pa kryer pagesën për shfrytëzim të vendparkingut.

3. Në rrugë, në vende, përkatësisht në hapësira të destinuar për ndalje dhe parkim, edhe në sipërfaqet e ndërtuara të komunikacionit të parapara për lëvizjen e këmbësorëve, nuk

lejohej lënia e mjeteve, të cilat nuk përdoren në komunikacion (të papërdorura, të paregjistruara ose të ngjashme) ose mjetet bashkëngjitëse, të cilat shfrytëzohen vetëm përkohësisht (rimorkio e lehtë ose kamp-shtëpiza, ose të ngjashme), sendet, materialet dhe të ngjashme të cilat pengojnë rrjedhën normale të komunikacionit apo e ndotin ambientin.

4. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve në hapësirat e parkimit për personat me aftësi të kufizuar, si dhe në vende të rezervuara për parkim nëse përdoruesi nuk i përket kategorive të përmendura.

5. Parkimi i një automjeti që nuk i përket kategorisë së automjeteve për të cilin është planifikuar parkimi.

6. Parkimi i automjeteve për kohë më të gjatë se koha e parashikuar për parkim në zonën e dhënë.

7. Nxënia e parkingjeve duke vendosur rrethoja ose pengesa të ngjashme pa pëlqimin e organit kompetent të kryeqytetit.

8. Shfrytëzimi i parkimeve publike për qëllime biznesore të aktivitetit të taksive, si dhe të aktivitetit të qiradhënies së makinave.

9. Parkimi i automjeteve komerciale, makinerisë së rëndë, automjeteve të punës, kamp-shtëpizave, rimorkio, traktorëve, makineri bujqësore, autobusëve, minibusëve, furgonëve, përveç në rastet kur kanë leje specifike nga N.P.L. "Prishtina Parking" apo drejtoritë përkatëse të Komunës së Prishtinës për të kryer shërbime të ngarkim/shkarkimit apo në aktivitete të kontraktuara dhe të pajisura me leje të punës nga Komuna e Prishtinës.

10. Për kategoritë e cekura në paragrafin 1 dhe 6 të këtij neni, N.P.L. "Prishtina Parking" mban mbikëqyrje përgjatë 24 orëve dhe 7 ditë në javë përmes ekipeve kujdestare të kontrollit. Përfundim nga paragrafi 10 i këtij neni bëjnë automjetet që janë brenda dimenzioneve të përshkruara në nenin 10, paragrafët 1.1 deri në 1.6.

## **Neni 22**

### **SHKELJET BREDA PARKINGJEVE TË MENAXHUARA NGA N.P.L "PRISHTINA PARKING" SH.A.**

1. Në rast të moskryerjes së pagesës për parkim, zyrtari (kontrollori) i N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A., obligohet të presë dhjetë (10) minuta nga momenti i parkimit të automjetit dhe nëse pas kalimit të këtij afati kohor qytetari nuk kryen pagesën, automjeti do të bllokohet përmes vendosjes së bllokadës. Vendosja e bllokadës bëhet nga zyrtarët (kontrollorët) e N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A.

2. Shkelja e përgjithshme e udhëzimeve të parkimit, duke përfshirë mosrespektimin e sinjalistikës horizontale dhe sinjalistikës vertikale të vendosur nga N.P.L “Prishtina Parking”.

3. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse shfrytëzuesi pas tetë (8) orë pritje nga koha e masës së ndëshkimit nga kontrollorët nuk ndodhet në vendngjarje ose kundërshton largimin e automjetit, zyrtarët (kontrollorët) e N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., në bashkëpunim me zyrtarët e Policisë së Kosovës, do të urdhërojnë largimin e automjetit brenda afatit të caktuar apo vendosin për lejimin e konfiskimit duke lajmëruar automjetin special (merimangën). N.P.L “Prishtina Parking” ka për obligim të njoftojë Policinë e Kosovës në situata të tilla.

4. Në rast se pagesa për zhblokim të automjetit nuk kryhet brenda tetë (8) ore, automjeti do të bartet në një nga parkingjet që gjenden nën menaxhimin e ndërmarrjes, ku për bartjen e automjetit qytetari obligohet të paguajë çmimin e përcaktuar nga Rregullorja për Shërbimin e Merimangës. Nëse personi të cilit i është bllokuar automjeti, paraqitet në vendparkimin e automjetit gjatë përgatitjes për bartje, do të obligohet të paguajë vetëm gjysmën e çmimit për bartje të automjetit sipas çmimoreve të ndërmarrjes.

5. Në rast se automjeti është parkuar në kundërshtim me këtë rregullore dhe bllokun/pengon mbarëvajtjen e trafikut rrugor, zyrtarët (kontrollorët) e N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., e lajmërojnë Policinë e Kosovës dhe presin të bëjnë bartjen e automjetit.

6. Për zhblokimin e automjetit, qytetarët duhet të paguajnë shumën në vlerë prej njëzet euro (20 €) në Ndërmarrjen “Prishtina Parking”. Kjo pagesë siguron të drejtën e qytetarit të parkojë për 24 orë në çdo zonë të menaxhuar nga N.P.L “Prishtina Parking”.

7. Qytetarët mund t’i shfrytëzojnë hapësirat publike të destinuara si vendparkingje publike përgjatë rrugëve publike/parkingjet komerciale, për dhjetë (10) minuta pa pagesë.

8. N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., ka të drejtën e lëshimit të biletës 24 - orëshe të parkimit në bazë të kësaj rregulloreje duke bërë bllokimin e veturave në rast të mospagesës së vendparkingut publik dhe ilegal, gjithashtu bartjen/zhvendosjen e mjeteve që janë në kundërshtim me këtë rregullore, përmes “bllokuesve” dhe “merimangës” të menaxhuar nga N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A.

9. Për bllokimin, deblokimin dhe bartjen/zhvendosjen e mjeteve vlen Rregullorja për shërbimin e transportit me “Merimangë” në territorin e Komunës së Prishtinës, me nr. 110-1205, e dt. 16.6.2010. Vendin (lokacionin) për vendosjen e mjeteve në autopark e cakton N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A., bazuar në lokacionin më të afërt ku lëshohet bileta 24 - orëshe.

## **Neni 23** **MBIKËQYRJA**

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të rregullores e kryen Drejtoria kompetente e inspektionit në kryeqytet, e cila gjatë mbikëqyrjes inspektuese është e obliguar dhe kompetente të mbikëqyrë:

- 1.1. Lejen e operimit të secilit parking publik dhe privat;
- 1.2. Përbushjen ose jo të kriterëve të përcaktuara me nenin 4 të kësaj rregulloreje lidhur me parkingjet private, si dhe dispozitat tjera që ndërlidhen me kriteret për operimin e parkingjeve publike;
- 1.3. Rregullsinë e përgjithshme teknike të parkingjeve publike dhe private;
- 1.4. Kontrollimin e procedurave të ndjekura nga ana e zyrtarëve të N.P.L. “Prishtina Parking” SH.A;
- 1.5. Kontrollimin e implementimit të çmimoreve të miratuar nga Kuvendi Komunal i Kryeqytetit;
- 1.6. Kontrollimin nëse parkingjet publike dhe private përgjithësisht operojnë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
- 1.7. Të urdhërojë ndërmarrjen publike/subjektin privat për mënjanimin e mangësive të evidentuara gjatë inspektimit brenda një afati të caktuar.

## **Neni 24** **PROCEDURA SIPAS ANKESËS**

1. Qytetarët e kryeqytetit në çdo kohë mund të ushtrojnë ankesë në Drejtorinë e Inspektionit vetëm për çështjet, të cilat ndërlidhen me autorizimet e kësaj drejtorie, ashtu siç është përcaktuar me nenin 23 të kësaj rregulloreje.
2. Në rast të ushtrimit të ankesës nga qytetarët në Drejtori të Inspektionit, sikur që është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, kompetent për vendosjen e çështjes do të jetë inspektori i Drejtorisë së Inspektionit.
3. Të gjitha ankesat tjera që nuk janë pjesë e autorizimeve të Drejtorisë së Inspektionit, sipas nenit 23 të kësaj rregulloreje, palët duhet t'i drejtohen N.P.L “Prishtina Parking” SH.A.



## Neni 25

### DREJTORIA E INSPEKSIONIT ËSHTË E AUTORIZUAR PËR SHQIPTIMIN E GJOBAVE QË NDËRLIDHEN ME SHKELJET NË VIJIM

1. Për shkeljet e parapara në nenin 21, paragrafi 1 dhe 4, personit fizik dhe personit përgjegjës i personit juridik, do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej tridhjetë (30) euro, ndërsa për personin juridik njëqind (100) euro.
2. Për shkeljet e parapara në nenin 21, paragrafi 8, personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej njëqind (100) euro, ndërsa për personin juridik pesëqind (500) euro.
3. Nëse personi juridik operon pa leje për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse sipas kësaj rregulloreje, do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej njëqind e pesëdhjetë deri në dhjetë mijë 1000.00 euro.
4. Operatorit publik ose privat i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje varësisht nga shkelja e konstatuar në shumë prej njëqind e pesëdhjetë deri në një mijë (150 – 1.000) euro.
5. Operatorit publik ose privat, i ndalohet që të kryejë shërbime të riparimit ose shërbime të larjes së automjeteve, apo aktiviteteve tjera që ndikojnë në funksionimin normal të parkimit, të njëjtit do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej njëqind e pesëdhjetë deri në një mijë e pesëqind (150 – 1.500) euro.
6. Nëse inspektori konstaton se operatori publik apo privat përsërit shkeljet e përshkuara më lart deri në tri herë e më tepër, do të iniciohet procedurë për revokimin e lejes.
7. Për shkeljet nga neni 21, N.P.L “Prishtina Parking” autorizohet në lëshimin e biletave 24 - orëshe të parkimit (20-100 euro).
8. Për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me këtë nen të kësaj rregulloreje, me qëllim të kryerjes së detyrave të punës me efikasitet, Drejtoria e Inspektionit ka të drejtë që të kërkojë ndihmë nga N.P.L “Prishtina Parking”, në mbarëvajtjen dhe lirimin e hapësirave publike nga parkingjet ilegale.

## Neni 26

### DISPOZITA SHFUQIZUESE

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës Nt.01-011/02-187748/19 e datës 1.8.2019 dhe Vendimi për çmimore me nr. 01-352/13-315051/19 i datës 30.12.2019.

**Neni 27**  
**HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**SHTOJCAT:**

- Rregullores do t'i shtohet/bashkëngjitet, si shtojcë/aneks edhe se si duhet të jenë dimensionet e gjatësisë dhe gjerësisë së vendparkingjeve, këndet, vijëzimi/shenjëzimi, mënyra e parkimit, varësisht nga lloji i rrugës njëkahore apo dykahore.
- Shtojca për çmimoren dhe kategorizimin e çmimeve.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-030/01-236535/23, më 26.12.2023**

**KRYESUES I KUVENDIT**  
**Pëllumb Bajçinovci**



Faqe 18 nga 21

---

## **Aneks 1**

### **Çmimorja e Parkingjeve në Komunën e Prishtinës**

1. Çmimorja për Parkingjet në Komunën e Prishtinës zbatohet nga N.P.L “Prishtina Parking”.
2. Çmimorja përcakton çmimet për kategoritë si në vijim:

#### **Zona I, parkingjet rrugore dhe jashtërrugore:**

- 1.2.1. Vizitorët në Zonën I, 1 euro për parkim deri në një orë;
- 1.2.2. Banorët rezidentë, pa pagesë për automjetin e parë dhe me tarifë prej 10 euro për regjistrim me qëllim të mbulimit të shpenzimeve administrative dhe mirëmbajtjes së sistemeve nga N.P.L “Prishtina Parking”;
- 1.2.3. Banorët rezidentë me pagesë prej 10 euro në muaj apo 100 euro në vit për regjistrimin e automjetit të dytë;
- 1.2.4. Banorët rezidentë me pagesë prej 45 euro në muaj apo 450 euro në vit për regjistrimin e automjetit të tretë;
- 1.2.5. Banorët rezidentë me pagesë prej 100 euro në muaj për automjetin e katërt e më shumë ose 1000 euro në vit;
- 1.2.6. Vizitorët mund të pajisen me bileta mujore për Zonën I, të cilat bartin kosto prej 100 euro në muaj ose 1000 euro në vit. Kufizimet e parkimit aplikohen sikur në nenin 8, paragrafin 1 të kësaj rregulloreje;
- 1.2.7. Automjetet në pronësi të bizneseve bartin kosto prej 45 euro për muaj ose 450 euro për një vit. Kufizimet e parkimit dhe regjistrimit aplikohen sikur në nenin 8, paragrafin 1, si dhe nenin 13, paragrafi 1 dhe 2 i kësaj rregulloreje;
- 1.2.8. Automjetet e punonjësve në Zonën I, bartin kosto prej 30 euro në muaj për automjet dhe 300 euro në vit. Kufizimet e parkimit dhe regjistrimit aplikohen sikur në nenin 8, paragrafi 1, si dhe nenin 13, paragrafi 1 dhe 2 i kësaj rregulloreje;
- 1.2.9. Lejet mujore për zonat komerciale sipas definimit të nenit 8, paragrafi i dytë i kësaj rregulloreje nuk mund të lëshohen për asnjë kategori, përjashtimisht paragrafit 4.2.5 dhe 4.2.6 të çmimores.
- 1.2.10. Të gjitha pagesat mujore dhe vjetore të bëhen përmes bankës, në llogarinë bankare të NPL –së “Prishtina Parking”.

#### **Zona I, parkingjet me laura:**

- 1.1.1. Parkimi në parkingjet me laura në Zonën I bart kosto prej 1 euro deri në një orë;
- 1.1.2. Parkimi ditor në parkingjet me laura në Zonën I bart kosto prej 7.5 euro deri në 24 orë. Kjo biletë aktivizohet automatikisht pas orës së 7 të parkimit. Nëse bileta shfrytëzohet për dalje nga parkimi me laurë, bileta konsiderohet e konsumuar;
- 1.1.3. N.P.L “Prishtina Parking”, përmes Rregullores së saj të brendshme që përcakton parkingun më të madh me laurë në Zonën I, i cili do të bartë kosto prej 0.5 euro për parkim deri në një orë apo 3 euro për parkim deri në 24 orë. Kjo biletë aktivizohet automatikisht pas orës së 6 të parkimit. Nëse bileta shfrytëzohet për dalje nga parkimi me laurë, bileta konsiderohet e konsumuar;
- 1.1.4. Parkimi mujor në Zonën I në parkingun me laurë sipas nenit 1.1.3 bart kosto prej 45 euro në muaj ose 450 euro në vit;

- 1.1.5. Parkingjet tjera, me laura në Zonën I nuk mund të lëshojnë leje mujore në më shumë se 20% të hapësirave dhe bart kosto prej 60 euro në muaj.

**Zona II, parkingjet rrugore dhe jashtërrugore:**

- 1.2.11. Vizitorët në Zonën II, 0.5 euro për parkim deri në një orë;
- 1.2.12. Banorët rezidentë, pa pagesë për automjetin e parë dhe me tarifë prej 10 euro për regjistrim me qëllim të mbulimit të shpenzimeve administrative dhe mirëmbajtjes së sistemeve nga N.P.L "Prishtina Parking";
- 1.2.13. Banorët rezidentë me pagesë prej 10 euro në muaj apo 100 euro në vit për regjistrimin e automjetit të dytë;
- 1.2.14. Banorët rezidentë me pagesë prej 30 euro në muaj apo 300 euro në vit për regjistrimin e automjetit të tretë;
- 1.2.15. Banorët rezidentë me pagesë prej 70 euro në muaj për automjetin e katërt e më shumë ose 700 euro viti;
- 1.2.16. Vizitorët mund të pajisen me bileta mujore për Zonën II, të cilat bartin kosto prej 70 euro në muaj ose 700 euro në vit. Kufizimet e parkimit aplikohen sikur në nenin 8, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje;
- 1.2.17. Automjetet në pronësi të bizneseve bartin kosto prej 30 euro për muaj ose 300 euro për një vit. Kufizimet e parkimit dhe regjistrimit aplikohen sikur në nenin 8, paragrafi 1, si dhe nenin 13, paragrafi 1 dhe 2 i kësaj rregulloreje;
- 1.2.18. Automjetet e punonjësve në Zonën II, bartin kosto prej 20 euro në muaj për automjet dhe 200 euro në vit. Kufizimet e parkimit dhe regjistrimit aplikohen sikur në nenin 8, paragrafi 1, si dhe nenin 13, paragrafi 1 dhe 2 i kësaj rregulloreje;
- 1.2.19. Leje mujore për zonat komerciale sipas definimit të nenit 8, paragrafi i dytë i kësaj rregulloreje nuk mund të lëshohen për asnjë kategori, përjashtimisht paragrafit 4.2.15 dhe 4.2.16 të çmimoreve.

**Zona II, parkingjet me Laura:**

- 1.1.6. Parkimi në parkingjet me laura në Zonën II bart kosto prej 0.5 euro deri në një orë;
- 1.1.7. Parkimi ditore në parkingjet me laura në Zonën II bart kosto prej 5 euro deri në 24 orë. Kjo biletë aktivizohet automatikisht pas orës së 10 të parkimit. Nëse bileta shfrytëzohet për dalje nga parkimi me laurë, bileta konsiderohet e konsumuar;
- 1.1.8. N.P.L "Prishtina Parking", përmes Rregullores së saj të brendshme që përcakton parkingun më të përshtatshëm me laurë në Zonën II, i cili do të bartë kosto prej 0.5 euro për parkim deri në një orë apo 3 euro për parkim deri në 24 orë. Kjo biletë aktivizohet automatikisht pas orës së 6 të parkimit. Nëse bileta shfrytëzohet për dalje nga parkimi me laurë, bileta konsiderohet e konsumuar;
- 1.1.9. Parkimi mujor në Zonën II në parkingun me laurë sipas nenit 1.1.3, bart kosto prej 30 euro në muaj ose 300 euro në vit;
- 1.1.10. Për banorët rezidentë të hapësirave ku eventualisht mund të shtrihet parkingu me laurë, zbatohet neni 8, paragrafi 1.
2. Për parkimin në Zonën I dhe II sipas definicionit të nenit 13, paragrafi 6, kostoja ditore është 5 euro.
3. Çmimet e mëposhtme vlejné për të gjitha zonat në raport me lëshimin e biletës 24 - orëshe:
- 1.3.1. Bileta 24 - orëshe e parkimit si rezultat i mospagesës së parkimit njëzet euro (20);

- 1.3.2. Konfiskimi i automjetit sipas urdhërit të policisë tridhjetë euro (30);
- 1.3.3. Bileta e mostërheqjes së automjetit nga parkingu i dizajnuar për pikën 5.3.2, si shtesë e gjobave paraprake, 5 euro për një ditë.